

Deklaratë për pjesëmarrjen me dëshirë në Programin Svit



PROGRAMI KOMBËTAR I DEPISTIMIT
DHE I ZBULIMIT TË HERSHËM TË
NDRYSHIMEVE PARAKANCEROZE, TË
KANCERIT TË ZORRËS SË TRASHË
DHE TË REKTUMIT

Ju lutemi ta plotësoni këtë deklaratë dhe të na e ktheni atë të nënshkruar në një zarf të mbyllur sa më parë, më e vona brenda një jave.

Para se të filloni ta plotësoni, lexoni broshurën bashkangjitur për Programin Svit. Nëse keni mëdyshje se si t'u përgjigjeni pyetjeve, na telefononi ose pyesni në ambulancë për këshillim mjekun tuaj të zgjedhur. Ju lutemi që të dhënat t'i shkruani qartë me shkronja shtypi.

E rëndësishme: Të dhënat tuaja personale do t'u bëhen të njohura vetëm personave të autorizuar të Programit Svit. Me të dhënat personale, do të veprojmë në përputhje me dispozitat në fuqi për mbrojtjen e të dhënave të personit.

Emri e mbiemri:

Datëlindja:

Rruga:

Vendi e numri postar:

Telefoni (i shtëpisë dhe celular):

Adresa elektronike (nëse keni):

Nëse dëshironi që postën tonë ta merrni në një tjetër adresë, shkruajeni atë këtu:

.....
.....

Emri dhe mbiemri i mjekut tuaj personal:

Adresa e ambulancës (emri, rruga, vendi dhe numri postar):

.....
.....

Ju lutemi që të na njoftoni me shkrim për çdo ndryshim të adresës!

Ju lutemi që ta lexoni me vëmendje pyetësoin në faqen pasuese dhe pastaj ta plotësoni dhe ta nënshkruani Deklaratën.

Ju lutemi, kthejeni faqen!

Ju lutemi përgjigjuni pyetjeve në vazhdim dhe shënoni përgjigjen që e mendoni se është e drejtë:

A keni bërë në të shkuarën kontrollin e plotë të zorrës së trashë dhe të rektumit (kolonoskopinë), për ç'gjë jeni përgatitur duke i pastruar zorrët PO JO

Kolonoskopia është kontrolli me ndihmën e të cilit mjeku me anë të një zorre elastike bën kontrollin e pjesës së brendshme të zorrës së trashë dhe të rektumit.

Nëse kësaj pyetje i jeni përgjigjur me PO, shkruani datën e përafërt të kolonospisë së fundit dhe përgjigjuni pyetjeve më poshtë:

a. A është zbuluar koliti ulçeroz ose sëmundja e Kronit? PO JO

b. A janë hequr polipet (polipet janë zgjatimet në mukozën e zorrëve dhe i paraprijnë kancerit; në polipe nuk përfshihen hemorroidet ose “damarët e artë”)? PO JO

c. A është zbuluar kanceri në zorrën e trashë ose në rektum? PO JO

d. Për shkak të ndryshimeve patologjike, të thëna në pikat a, b apo c, a shkoni për kontrolle të rregullta tek mjeku? PO JO

Nëse keni ndonjërin prej sëmundjeve të lartpërmendura dhe për këtë arsye shkoni tashmë për kontrolle të rregullta te mjeku specialist, nuk do t'ju përfshijmë në Programin Svit të depistimit, sepse mjekët tuaj kujdesën tashmë siç duhet për shëndetin tuaj. Ju rekomandojmë që t'i vazhdoni kontrollet e rregullta.

Nëse në tre vitet e fundit e keni bërë kolonoskopinë dhe rezultati ka qenë normal, do t'ju thërrasim në Programin Svit brenda dy viteve. Rezultat normal do të thotë se me kolonoskopi nuk është zbuluar kanceri i zorrës së trashë ose i rektumit, koliti ulçeroz, sëmundja e Kronit ose polipi.

Unë, i (e) poshtë-nënshkruari/-a jam njohur me synimin dhe procedurën e programit kombëtar të depistimit dhe të zbulimit të hershëm të ndryshimeve parakanceroze dhe të kancerit të zorrës së trashë e të rektumit dhe dëshiroj të marr pjesë në Program.

E kam kuptuar se pjesëmarrja ime në Programin Svit është me dëshirën time dhe se mundem të dal nga Programi kur të dua, edhe pse tashmë kam dhënë dakordësinë për pjesëmarrje.

Nënshkrimi dora vetë: Data: